

## IPA 2008 “Përmirësimi i Mbrojtjes së Konsumatorit kundër Zoonozave në Shqipëri”

### Objektivat e projektit

**Objektivi i Përgjithshëm** për realizimin e të cilit projekti do të kontribuojë është i dyfishtë:

1. Sigurimi i një mbrojtjeje më të mirë të shëndetit të kafshëve dhe njerëzve kundër sëmundjeve kryesore zoonotike;
2. Rritja e të ardhurave në sektorin e bujqësisë në përgjithësi dhe atë të blegtorisë në veçanti.

Qëllimi i projektit është që "Te merren dhe zbatohen masa të përshtatshme dhe të favorshme për zhdukjen e sëmundjeve kryesore zoonotic në vend dhe të reduktohen incidentet dhe humbjet ekonomike të shkaktuara nga sëmundjet zoonotic në vend".

Ky objektivi i projektit synohet të realizohet nëpërmjet arritjes së rezultateve të mëposhtme

Rezultati 1: Kapaciteti institucional dhe administrativ i Shërbimit Veterinar të Shtetit është forcuar në mënyrë të konsiderueshme;

Rezultati 2: Kompetenca teknike e Shërbimit Veterinar të Shtetit për kontrollin e zoonozave I cili është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme;

Rezultati 3: Sistemi i laboratoreve veterinarë është forcuar, modernizuar dhe përmirësuar në mënyrë të ndjeshme;

Rezultati 4: Njësia Kombetare e Epidemiologjisë Veterinare është e aftë të ofrojë informacion të besueshëm, bazuar në vëzhgimin, monitorimin dhe njohjen e situatës epidemiologjike në vend dhe interpretimin e të dhënave;

Rezultati 5: Janë formuluar, përgatitur dhe zbatuar masat e duhura për kontrollin e sëmundjeve kryesore zoonotike;

Rezultati 6: Disa zona janë deklaruar “*të pastërta nga bruceloza dhe tuberkulozi*”, dhe është përgatitur dosja e aplikimit në përputhje me Kodin Global të Shëndetit të Kafshëve; dhe,

Rezultati 7: Është bërë ndërgjegjësimi i fermerëve, blegtorëve, prodhuesve, përpunuesve e konsumatorëve të produkteve me origjinë shtazore mbi rreziqet që paraqesin zoonozat.

## **Kohëzgjatja e Projektit**

Projekti ka filluar më dt. 07 Dhjetor 2009; ai do të zbatohet gjatë një periudhe prej 39 muajsh, e ndarë në tre faza:

1. Faza e krijimit (3 muaj);
2. Faza përgatitore (6 muaj)
3. Faza e zbatimit (30 muaj).

Agjensia Kontraktuese: Delegacioni i KE, Tirane

Perfitues: MUBUMK

## **Sëmundjet prioritare**

Projekti PAZA do të përqendrohet në gjashtë sëmundjet zoonotike kryesore, dhe përkatësisht:

- Brucelozën në bagëtitë e imta (sëmundja prioritare);
- Brucelozën e gjedhit;
- Plasjen;
- Tuberkulozin e gjedhit;
- Tërbimin, dhe
- Murtajën Klasike të Derrave

Masat profilaktike të financuara nga shteti kundër brucelozës, tuberkulozit, plasjes dhe murtajës së derrave dhe masat e marra nga qeveria për të nxitur regjistrimin e gjedhëve dhe bagëtime të imta, ofrojnë një bazë për aktivitetet e projektit.